

**Statuti i**  
**“Solaris Power”**  
**- Shoqeri me përgjegjësi të kufizuar**

Në këtë Statut

- "Ligji" është Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për sipërmarrësit dhe shoqëritë tregtare"
- "Statuti" është statuti i shoqërisë.

**KAPITULLI I**  
**Dispozita te Përgjithshme**

**Formimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja dhe Selia Zyrtare**

**Neni 1**  
**Data e themelimit, Emri dhe Themeluesit**

1. Sot, më 31 Maj 2019, Unë, themeluesi, kam themeluar një shoqeri me përgjegjësi të kufizuar me emrin Solaris Power Sh.p.k.
2. Oraku themelues i shoqërisë është Z. Yiannis Panagiotopoulos, i lindur në Greqi, me vendbanim në rrugën 15 Tinos 153 43 Agia Paraskevi, Athinë, Greqi.

**Neni 2**  
**Objekt**


Shoqëria do të kryejë aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike.

**Neni 3**  
**Kohëzgjatje**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë 20 vjet.

**Neni 4**  
**Selia zyrtare**

Selia ligjore e kompanisë është në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Kullat Binjake, Kulla 1, Kati 5, Tiranë, Shqipëri.



## **KREU II Kapitali**

### **Neni 5 Kapital themeltar**

Kapitali themeltar fillestar i shoqerise është 500.000 leke. Pjesëmarrja e ortakut themeluesit në kapitalin themeltar fillestar të shoqërisë është në përputhje me kontributet e tij si më poshtë:

- a. Ortaku themelues i shoqerise Yiannis Panagiotopoulos: pronar i një (një) kuote me vlerë te përgjithshme prej 500.000 leke Lekë që përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqerise.
- b. Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri e luajtshme/ pasuria e paluajtshme ose të drejta).

### **Neni 6 Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit**

1. Kapitali i shoqërisë mund të zmadheohet nëpërmjet nenshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontribut në para dhe me ane te kontributit në natyrë nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesave të Administratorit.
2. Në asnjë rast, shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur kontributin e tij në kapitalin themeltar të shoqerise.
3. Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim nën të njëjtat kushte si për ndryshimin e Statutit.
4. Në të gjitha rastet, zvogelimi i kapitalit i prek ortaket në të njëjtën masë ndaj pjesëve te tyre përkatëse në kapital.

### **Neni 7 Transferimi i Aksioneve**

1. Kuotat e kapitalit e te drejtat që rrjedhin prej tyre mund te fitohen ose kalohen nëpërmjet:
  - a. Pjesëmarrja në kapitalin aksionar të autorizuar me themelimin e shoqërisë;
  - b. Blerje;
  - c. Trashëgimise;
  - d. Dhurimit;
  - e. Mënyra të tjera të parashikuara nga Ligji.
2. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakeve, përveç nëse parashihet ndryshe në Statut.
3. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme nëpërmjet trashëgimisë.



## KREU III

### Vendimmarrja dhe organet drejtuese

#### Neni 8 Organi vendimmarrës

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve është organ i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të parapara me ligj.

Asambleja e Përgjithshme vendos për çështjet e mëposhtme të kompanisë:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emerimin dhe shkarkimin e Administratorëve;
- ç) emerimin dhe shkarkimin e likuidusve dhe eksperteve kontabel te autorizuar;
- d) Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në pikën “c” dhe “ç”;
- dh) monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave të biznesit nga administratorët, duke përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve te ecurise se veptimatarise;
- e) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve te ecurise se veptimatarise;
- ë) Shpërndarja e fitimeve vjetore;
- f) Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themeltar;
- g) Ndarjen e kuotave në pjesë dhe tërheqjen e tyre;
- h) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedurat tjera kundër adminstratoreve;
- i) Ristrukturimin dhe shpërbërjen e shoqërisë;
- j) Miratimin e rregullave të veta të procedurës;
- k) Cështje të tjera të përcaktuara me ligj ose me statutin.

2. Një ortak mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme nga një ortak tjetër i autorizuar prej tij ose një person i tretë i autorizuar.

3. Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i një ortaku tjetër në Asamblenë e Përgjithshme.

4. Autorizimit mund te jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtiiin rend dite.



Page 3/9

## **Neni 9**

### **Menyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme**

1. Asambleja e Përgjithshme mund të thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose, nëse parashikohet nga statuti, nepermjet njoftimit me postë elektronike. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën dhe orën e mbledhjes dhe të dorëzohet së bashku me rendin e ditës për të gjithë anëtarët jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblese.
2. Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur në përputhje me Paragrafin 1, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortaket e shoqërisë bien dakord të marrin vendime pavarësisht parregullsise.

## **Neni 10**


### **Kuorumi**

1. Në rast të marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vetëm vendime të vlefshme në qoftë se marrin pjesë ortaket me të drejtë vote që zoterojnë më shumë se 30% të kuotave.
2. Në rast të marrjes së vendimeve që kërkojnë shumicë të cilesuar, sipas nenit 87 të Ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortaket që zoterojnë me shume se gjysmen gjysmen e numrit të përgjithshëm të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkrese, ose me mjete elektronike në përputhje me paragrafin 3 të nenit 88 të këtij ligji.
3. Nëse mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme nuk mund të mbahet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në Paragrafin 1, mbledhja do të përsëritet me të njëjtën agjendë të propozuar brenda 30 ditëve.

## **Neni 11**

### **Marrja e vendimeve**

1. Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicë votash prej tri të katertave të zotëruesve të kapitalit, të ortakeve pjesëmarrës në votim për ndryshimin e Statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit themeltar, shpërndarjen e fitimit, rristrukturimin dhe shpërbërjen e shoqërive.
2. Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakeve pjesëmarrës për çështje të tjera siç janë: Përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë; emerimi dhe shkarkimi i administratorëve; emerimi dhe shkarkimi i likuiduesve dhe ekspertëve kontabel të autorizuar; Vendosja e shpërblimeve; mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga Administratorët duke përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raportve të ecurisë së veprimtarisë; Përfaqësimi i shoqërisë në gjykatë dhe në procedura të tjera ndaj Administratorëve; Miratimin e rregullave të veta procedurale për thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme.



3. Çdo ndryshim i Statutit duhet të depozitohet në QKB me qëllim që të pasqyrojë ndryshimet në skeden e shoqërisë.

### **Neni 12** **Përjashtimi nga e drejta e votes**

1. Ortaku nuk mund të votojë nëse Asambleja e Përgjithshme vendos për:

- a) Vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) Shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) Çdo kërkesë kundër tij në emër të shoqërisë;
- d) Dhënie ose jo të ndonjë përfitimi të ri.

2. Kur një ortak përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtën konflikt interesi ashtu si dhe ortaku që ai përfaqëson.

### **Neni 13** **Administrimi**

1. Asambleja e Përgjithshme emeron një ose më shumë persona fizikë si Administratorë të shoqërisë, për një afat të përcaktuar me Statut që nuk i kalon 5 vjet, me të drejta ripërteritje.

2. Administratori i shoqërisë për një afat 5 (pesë) vjeç, me të drejta ripërteritje, është Z. Yiannis Panagiotopoulos, i lindur në Athinë, Greqi, me 17.11.1979, Mbajtës i pasaportës Nr. AN3471722 dhe nr. identifikimi personal nr. 065358924 leshuar nga Qendra Kombëtare e Pasaportave (QKP) me 19 Nentor 2016 dhe e vlefshme deri më 18 Nentor 2021, dhe me vendbanim në adresën Rruga 15 Tinos 153 43 Agia Paraskevi, Athinë, Greqi.

### **Neni 14** **Të drejtat dhe detyrimet e Administratorëve**

Administratori ka të drejtë dhe detyrohet të:

- a) Administrojë aktivitetin tregtar të përditshëm të shoqërisë;
- b) Përfaqëson interesat e shoqërisë me palët e treta;
- c) Mbanë dhe siguron dokumentet e nevojshme ligjore dhe librat kontabël;
- d) Siguron dhe nënshkruan deklaratën vjetore të llogarive, llogaritë e konsoliduara dhe raportin e veprimtarisë;
- e) Emëron/ punëson dhe shkarkon punonjësit e shoqërisë;
- f) Kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj ose në statut.



## **Neni 15**

### **Përgjegjësitë e Administratorit**

Administratori i shoqërisë duhet:

1. Kryen detyrat e tij të përcaktuara me ligj dhe Statut në mirëbesim në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi që përfshin qëndrueshmërinë mjedisore të veprimtarive të saj;
  - b) Ushtron kompetencat që i janë dhënë atij me ligj dhe me Statut vetëm për qëllimet e përcaktuara aty;
  - c) Merr në konsideratë çështjet për të cilat nevojitet vendimmarrje;
  - d) Shmang konfliktet aktuale dhe të mundshme ndërmjet interesave personale dhe atyre të shoqërisë;
  - e) Kryen detyrat e tij me profesionalizëm dhe në mënyrë të arsyeshme.
2. Gjatë kryerjes së detyrave të tij, Administratori është përgjegjës për çdo veprim ose mosveprim të arsyeshëm të lidhur me qëllimin e shoqërisë tregtare, përveç rasteve kur veprimi ose mosveprimi është bërë në mirëbesim, bazuar në hetimin dhe informacionin e arsyeshëm dhe racionalisht të lidhura me qëllimet e shoqërisë.
3. Në rastet kur Administratori vepron në shkelje të detyrave të tij dhe shkel standardet profesionale sipas pikës 1 dhe 2 të këtij neni, ai është i detyruar të kompensojë shoqërinë për çdo dëm që ka ndodhur për shkak të shkeljes, çdo fitim personal të bërë nga ai ose personi i lidhur me të, duke shkelur detyrat e tij ndaj kompanisë. Administratori ka barrën e vërtetimit të pajtueshmërisë me detyrat dhe standardet.
4. Administratori duhet të respektojë dhe të mbrojë çdo informacion në lidhje me veprimtaritë financiare dhe ekonomike të shoqërisë, përveç rasteve kur një informacion i tillë kërkohet nga autoritetet kompetente për zbatimin e ligjit.
5. Administratori, personalisht ose duke autorizuar shprehimisht një person tjetër, duhet të aplikojë në emër të shoqërisë, në çdo institucion publik për marrjen e licencave ose lejeve që janë të nevojshme për mirëfunksionimin e shoqërisë dhe të lidhura me objektivat e saj siç përshkruhet në këtë Statut.

## **Neni 16**

### **Punonjësit e kompanisë**

1. Punonjësit e shoqërisë punësohen dhe shkarkohen me vendim të administratorit në përputhje me Kodin e Punës, Statutin e shoqërisë dhe aktet e tjera ligjore të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme.
2. Numri i punonjësve, struktura dhe pagesat miratohen nga Asambleja e Përgjithshme, me propozim të Administratorit.
3. Çdo 6 muaj Administratori duhet të informojë Asamblenë e Përgjithshme për numrin e të punësuarve në shoqëri.



**KREU IV**  
**Viti financiar - Ekspert**

**Neni 17**  
**Viti financiar**

Viti financiar fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor të çdo viti kalendarik, përveç vitit të parë financiar, që fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR) dhe mbyllet më 31 dhjetor.

**Neni 18**  
**Raporti vjetor financiar**

1. Administratori ose kontabilisti i miratuar duhet të paraqesë raportin vjetor brenda 2 (dy) muajve nga fundi i vitit financiar.
2. Raporti financiar përfshin informacion në lidhje me të hyrat, shpenzimet dhe çdo informacion tjetër financiar që lidhet me veprimtarinë e shoqërisë.
3. Asambleja e Përgjithshme miraton raportin vjetor financiar dhe kontabël brenda 6 (gjashtë) muajve pas përfundimit të vitit financiar dhe në çdo rast në përputhje me afatin ligjor të parashikuar në ligj.

**Neni 19**  
**Përgjegjësitë e Ekspertit Kontabel të Autorizuar**

1. Ekspertit kontabel i autorizuar emërohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
2. Eksperti kontabel i autorizuar ka detyrimin të kontrollojë të gjitha dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomike të shoqërisë, kontrollin vjetor dhe periodik të ushtruara prej tij për rastet kur ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.
3. Në përfundim të kontrollit, eksperti kontabel i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor, si dhe raportin për kontrollet periodike, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë dhe dorëzojnë në kohë ortakeve për shqyrtim dhe miratim bazuar në të drejtën e tyre për të votuar.




**KAPITULLI V**  
**Prishja - Riorganizimi i shoqërisë**

**Neni 20**  
**Prishja dhe Likuidimi**

1. Shoqëria mund të prishet në çdo kohë, në rrethanat e mëposhtme:
  - a. kur mbaron kohe zgjatja për të cilën është themeluar;
  - b) me vendim të Asamblesë së Përgjithshme;
  - c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
  - d) nëse nuk ka kryer asnjë aktivitet tregtar për dy vjet dhe nuk njoftuar pezullimi i veprimtarisë statusin në përputhje me paragrafin 3 të nenit. 43 të Ligjit Nr. 9723 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
  - e) me vendim të Gjykatës.
  
2. Në këtë rast, Ortaket marrin vendim me shkrim, në të cilat parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë duke emëruar një ose më shumë likuidues dhe çdo dokument i lëshuar nga shoqëria duhet të ketë emrin e likuidatorëve dhe emërimin shtesë “Shoqëri në likuidim e siper”.
  
2. Prishja e shoqërisë tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.
  
3. Likuidimi kryhet nga likuiduesit të emëruar nga Ortaket. Kur Ortaket nuk marrin një vendim mbi emërimin e likuiduesve brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës për emërimin e një likuiduesi.

**Neni 21**  
**Riorganizimi i shoqërisë Ndarja-Bashkimi**

Shoqëria mund të ndahet, bashkoet në bazë të Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakeve sipas dispozitave ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.





**KREU VI**  
**Dispozitat përfundimtare**

**Neni 22**  
**Mosmarrëveshjet**

Per mosmarrëveshjet që lindin ne lidhje me zbatimin ose interpretimin e këtij Statuti, si dhe çdo mosmarrëveshje ndërmjet shoqerise dhe palëve të treta, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

**Neni 23**  
**Ndryshimet e akteve nënligjore**

1. Çdo ndryshim i akteve nënligjore të shoqerise mund të bëhet vetëm përmes një vendimi me shkrim nga Asambleja e Përgjithshme.
2. Ndryshimi do të konsiderohet i ligjshëm vetëm pas pasqyrimit të tij në QKR.

**Neni 24**  
**Baza Ligjore**

1. Shoqeria do të kryejë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë Statut dhe me dispozitat ligjore të legjislacionit shqiptar.
2. Përveç nëse parashikohet ndryshe në këtë Statut, zbatohen dispozitat e Ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Kodit Civil dhe çdo ligj tjetër specifik i Republikës së Shqipërisë.

**Neni 25**  
**Hyrja në fuqi**

Ky Statut është hartuar në gjuhën shqipe, në 4 (katër) kopje, me vlerë të barabartë ligjore, dhe pas miratimit të saj nga Ortaku i vetëm themelues, nënshkruhet dhe depozitohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për miratim përfundimtar.

**“SOLARIS POWER”**  
**SHOQERI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

Ortaku themelues

Z. Yiannis Panagiotopoulos

I përfaqësuar në mënyrë të rregullt dhe të ligjshme me Prokurore te Posaçme nga

Z. Klevis Limaj

